



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Tiranë, 27 prill 2021. Në vijim të masave administrative dhe procedurale të ndërmara nga Prokurori i Përgjithshëm për të garantuar funksionimin normal të prokurorisë në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore për periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore, prokuroria është angazhuar për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, në kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm.

Përgjatë periudhës 23.04.2021 – 26.04.2021 prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë raportuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme, mbi veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, si më poshtë:

- Për veprën penale, Neni 325 “Pengimi i subjekteve zgjedhore” - **2** Kallëzime/referime/ ardhur me transferim;
- Për veprën penale, Neni 327 “Shkelja e fshehtësisë së votimit” - **2** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht;
- Për veprën penale, Neni 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” - **3** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht dhe **1** material kallëzues ardhur me transferim;
- Për veprën penale, Neni 328/a Përdorimi i funksionit publik” - **11** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht si dhe **8** materiale kallëzuese të ardhura me transferim;
- Për veprën penale, Neni 330 “Pengimi i zgjedhësit” - **1** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht;
- Për veprën penale, Neni 248 “Shpërdorim detyre në lidhje me aktet ligjore për zgjedhjet” - **7** Kallëzime/referime/ regjistruar kryesisht;
- Për veprën penale, Neni 329 “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” - **1** Kallëzime/referime/ ardhur me transferim.

Nga referimet në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për veprat e sipërcituara rezulton se janë regjistruar 8 procedime penale, 18 materiale kallëzuese janë në fazën e verifikimit paraprak dhe 6 materiale kallëzuese i janë transferuar SPAK –ut për kompetencë lëndore.